



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 91

Prishtinë, më 24.01.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla –S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Pal Lekaj dhe Valdete Bajrami.

Mungoi: Milena Miliçeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha, OSBE; Rita Spahiu, Granit Berisha dhe Egzon Pacolli- praktikë; Agnesa Haxhiu- KDI; Dren Ajeti- GLPS; Shefki Kastrati- NDI; Adelina Nitaj- Lëvizja FOL; Driton Vitia- ‘Kosova Sot’; Blerim Uka- Indekonline dhe Argjend Zejmaj, GP/AAK.

Mbledhjen e kryesoi Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Nga Stafi Mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 22 dhjetor 2016;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Znj. Bajrami propozoi që të ketë ndryshim të orarit të mbledhjeve të Komisionit nga ora 11:00 të bëhet në orën 10:00 ose 12:00 po ditën e martë. Njoftim për Raportin Kundër Korrupsion. Njoftim për organizim të përbashkët të tre komisioneve. Më 30.01.2017 diskutim për raportin e Transparency International duke ftuar drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion dhe përfaqësues të OJQ-ve.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 22 dhjetor

Kryetarja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16 dhe 22 dhjetor, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Kryetarja paraqiti një shqetësim se në strategjinë legjislative të vitit të kaluar më 30.06.2016, ka qenë e paraparë që të procedohet në Kuvend projektligji për konfiskimin e pasurisë së paligjshme gjë për të cilën nuk parashihet as në strategjinë Legjislative të këtij viti. Për këtë ligj si duket është hequr dorë por arsyet që ne nuk i dimë. Kemi marrë disa propozime nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike që të përfshihen në planin e punës. Ky grup ka propozuar monitorim për ligjin për Gjykatat në vazhden e monitorimeve të pakos ligjore për sistemin e drejtësisë. Po ashtu monitorim të ligjit për Prokurorinë e Shtetit dhe vazhdimi i monitorimit të ligjit për Agjencisë Kundër Korrupsion, por edhe tryezë për monitorimin e ligjeve dhe ka shpreh gatishmëri që të ndihmojë në të gjitha këto. Mendoj se si komision duhet të fokusohemi në monitorim, por mos të tregohemi shumë ambicioz se nuk po zbatohet plani i punës ashtu si duhet, por po vendosim që të monitorojmë disa ligje që vërtet janë të rëndësishme. Ato ligje të fushës Kundër Korrupsion mund t'ia lëmë Grupit Punues që drejtohet nga znj. Bajrami. Ndërkohë ne fokusohemi te ligjet e tjera që mund të jenë me interes.

Armend Zemaj tha se Plani i Punës është një udhërrëfyes që na lehtëson dhe planifikon me ardhjen e ligjeve që jo gjithmonë është i saktë sepse varet më shumë edhe nga sponsorizuesi me strategjinë legjislative, por edhe punët që po na dalin këtu që nuk janë shumë të rralla. Komisioni të arrijë të bëjë një përmbledhje efektive edhe në hartimin e legjislacionit dhe në mbikëqyrje. Zemaj propozoi që projekt-rregullorja për Kuvend të jetë në gjashtë mujorin e parë dhe atë muajin shkurt sepse do të fillohet me punëtorinë po këtë muaj. Besoj se do të arrijmë ta harmonizojmë draftin e parë dhe më pas do ta diskutojmë me Grupet Parlamentare ose edhe para kryesisë dhe ata le të vendosin se si të procedojnë pasi duhet të kemi edhe konsensus politik. Ndërsa te mbikëqyrja e ligjeve besoj se duhet të jemi pak konciz sepse do të vijmë një mori projektligjesh që do të organizohen edhe Dëgjime Publike për të qenë më efikas. I kemi disiplinuar edhe të interesuarit për të ardhur me propozime konkrete dhe jo si të kaluarën që janë bërë pjesë të debateve dhe në fund nuk kanë pasur ndonjë propozim. Sa i përket ligjit për Gjykata është e rëndësishme që të monitorohet duke pohuar se do të na ndihmojë edhe ne në lidhje me monitorimin që kemi bërë të KGJK-së dhe KPK-së. Së bashku me deputetin Agim Aliu kemi mbajtur 2-3 takime me disa institucione që e kanë kompetencë implementimin e Ligjit për Kundërvajtje me kërkesë të policisë së Kosovës sepse aty është parë që ka mospërputhje të legjislacionit. Kemi qenë pak të shqetësuar me mënyrën e interpretimit të ligjit, por edhe për

përgatitjen për të qenë të gatshëm kur të hyjë ligji për kundërvajtje në fuqi. Sidomos nga organizatat buxhetore dhe agjencitë që janë të detyruara t'i zbatojnë gjobat qoftë ato mandatare qoftë ato që bien në fushë veprimtarinë e Policisë së Kosovës. Do të takohemi sërish nesër me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe zyrën e Kryeministrit që t'i shpejtojmë hapat se Ligji për Trafikun e Komunikacionit Rrugor i cili nuk ka marrë mendim nga Komisioni ynë bie ndesh me Ligjin për Kundërvajtje. Krahas ligjit për gjykata të njëjtën kohë mund të bëjmë monitorimin e ligjit për Kundërvajtje sepse ka të bëjë pothuajse me të njëjtët institucione dhe po ashtu të monitorojmë edhe Ligjin për Prokurorinë. Ndërsa sa i përket projektligjit për konfiskimin e pasurisë së paligjshme që nuk është në strategjinë mund të marrim një nismë edhe si Kuvend, edhe si Komision për nxjerrjen e këtij ligji.

Selvije Halimi tha se e përkrah këtë Plan të Punës pavarësisht faktit se a do të arrijmë si komision ta përmbushim. Interesimi ynë do të ishte ta përfundojmë këtë plan por të synojmë edhe objektiva të tjera dhe po ashtu propozimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike i përkrah për t'u futur në Plan të Punës. Gjatë monitorimit të ligjit për KGJK dhe KPK na është thënë se ligji për Kundërvajtje ka shkaktuar probleme dhe do ishte mirë që këtë ligj ta kemi prioritet për monitorim. Sa i përket ligjeve dhe shqetësimeve që mund të kemi si anëtar të komisionit që ndonjë ligj i fushës tonë nuk vjen në Kuvend nga Qeveria ne kemi mandat si komision që të marrim nismat ligjore dhe të bëjmë plotësim -ndryshimet jo vetëm në ligjet e fushës, por edhe në ligjet e tjera që janë në interes të qytetarëve t'i rregullojmë. Në fund znj. Halimi tha se jam pro këtij plani të vitit 2017.

Pal Lekaj tha se sa i përket ligjit për Kundërvajtje ka mospërputhje dhe nuk është në harmoni me ligjet e tjera dhe në këtë drejtim është mirë që ne, si komision, ta japim kontributin tonë. Ndërsa sa i përket mos ardhjes së projektligjit për konfiskim të pasurisë së paligjshme duhet ta kemi një dakordim të të gjitha grupeve dhe pse jo mos të merret një nismë nga komisioni që të bëjmë një ligj ashtu si duhet.

Armend Zemaj kërkoi nga kryetarja se nëse mbani takime me kryetarët e komisioneve, të bisedoni që projektligjet mos të kalojnë në Kuvend pa kaluar në Komisionin për Legjislacion dhe është pikërisht ligji për Rregullat e Komunikacionit Rrugor i cili nuk ka kaluar në komisionin tonë dhe sot ka probleme në zbatim dhe është në kundërshtim me ligjin për Kundërvajtje. Po ashtu edhe projektligji për automjete është në kundërshtim me ligjin për Kundërvajtje.

Meqë nuk pati më diskutime, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Plani i Punës për vitin 2017 të miratohet duke u përfshirë draft-rregullorja e Kuvendit dhe Raporti për Mbikëqyrjen e Ligjeve për KPK dhe KGJK (në seancë plenare të jetë një raport më i përmbledhur) në muajin shkurt, ndërsa për muajin mars të parashihen mbikëqyrja e ligjit për Gjykata, Prokurorinë e Shtetit dhe ligjin për Kundërvajtje.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim

Kryetarja paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim duke pohuar se ky projektligj është më i avancuar se ligji që është tani dhe po i njëjti projektligj parasheh procedurën jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve apo mosmarrëveshjeve në fusha të ndryshme. Vërejtjet e mia janë më shumë te parimet e ndërmjetësimit sepse mendoj të

forcohem me shumë te parimet e ndërmjetësimit duke e ditur që është një projektligj i rëndësishëm. Po ashtu znj. Haxhiu pohoi se ka kundërthënë ndërmjet neneve, por edhe afatet kohore duhet të precizohen më qartë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarojnë nëse kanë ndonjë vërejtje apo sugjerim.

Agim Aliu tha se komisioni do të duhej t'i jepte përkrahjen sepse është një projektligj i avancuar dhe është mirë që ka ardhur në këtë formë pa plotësime dhe plotësime. Ndryshimi në këtë projektligj ka të bëjë se është shtuar ndërmjetësimi i detyruar dhe mendoj se është bërë mirë duke pasur parasysh që jemi duke përcjellë legjislacionin gjatë gjithë kësaj kohe është që të bëhet sa më shumë shkarkimi i gjykatave. Në fund z. Aliu shtoi se e përkrah dhe e vlerësoi lart këtë projektligj duke pohuar se jo vetëm ne, në komision, ta votojmë, por edhe në seancë plenare ky projektligj duhet të votohet dhe të përkrahet nga deputetët.

Kryetarja tha se ajo çfarë më bëri përshtypje në projektligj neni 2, paragrafi 3 se 'Ndërmjetësimi dhe procedura e ndërmjetësimit nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje' gjë që mendoj që është shumë mirë që është paraparë kjo dispozitë. Si subjekt politik ne e mbështesim në parim dhe vërejtjet tona do t'i paraqesim në seancë plenare. Po ashtu kam marrë disa vërejtje nga ndërmjetësuesit e lecencuar që mund t'i inkorporojmë në proces të amendamentit të projektligjit.

Armend Zemaj potencoi se ka një vërejtje parimore duke pohuar se tashmë kemi projektligjin për përbarim, projektligjin për noterinë, ndaj të gjitha këto do duhej të ishin të familjarizuara me njëra-tjetrën në strukturë, përmbajtje, rregullat por edhe vetë synimet që ndërliken me vendet demokratike. Mënyra e organizimit i lihet krejtësisht ministrisë dhe nuk është ashtu siç e kanë oda e përbaruesve me një lloj autonomie në çështjet procedurale dhe në këtë aspekt mund t'i harmonizojmë dhe t'i fuqizojmë me ligj. Mendoj se si projektligj të kaloj në parim.

Meqë nuk pati më diskutime, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-135 për Ndërmjetësim

5. Të ndryshme

A. Njoftim për Raportin Kundër Korrupsion

Valdete Bajrami, si kryesuese e Grupit Punues për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, sipas ligjit Agjencia Kundër Korrupsion duhet t'i raportojë Kuvendit, por edhe ne duhet t'i raportojmë Agjencisë për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2013-2017, për periudhën korrik-dhjetor 2016. Për këtë periudhë nuk ka ndonjë ndryshim nga ajo që është raportuar më parë, përveç te pika monitorimi i Ligjit për Financimin e subjekteve politike, ku në vitin 2016 nuk është bërë monitorimi i këtij ligji, por është shënuar rezultat konkret. Me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe me miratim të Kuvendit, (me rastin

miratimit të Ligjit Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017), fondi për auditimin e subjekteve politike që është pjesë e buxhetit të Kuvendit të Kosovës është rritur nga 60.000 € në 120.000 €.

B. Njoftim

Kryetarja: Tre Komisionet Parlamentare me kryetarë dhe nënkryetarë që janë komisioni ynë, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ta mbajnë një takim të përbashkët, ku do të diskutojmë për çështje që ka të bëjë me mos auditimin e Financave të Partive Politike. Besoj që të adresohet ky problem sepse zgjidhja aktuale si e parashohin ligjet nuk ka funksionuar, ndoshta për shkak vullnetit, gjë që nuk është zgjidhje e mirë. Kam menduar të bëj një takim të përbashkët, ku do të diskutojmë këtë problem. Mundësia për ta mbajtur këtë takim është më 3.02.2017 duke u konsultuar me dy kryetarët e komisioneve tjera, atë të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

C. Njoftim

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit se nesër, më 25.01.2017, do të publikohet raporti i ‘Transparency International 2016’, i cili tregon shkallën e korrupsionit në vende të ndryshme përfshirë edhe Kosovën. Më 30.01.2017 së bashku me Agjencinë Kundër Korrupsion dhe shoqërinë civile do të organizojmë diskutim për raportin ‘Transparency International’ duke marrë pajtimin e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

